




Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Shkolla "Mileniumi i Tretë"



Mileniumi i Tretë




Letërnjoftimi i shkollës

Tipi: Shkollë fillore dhe e mesme e ulët (klasat 1-9)

Themelues: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Lokacioni: rr. "Isa Kastrati", p.n., Prishtinë
(rreth 1 km largësi nga shkolla "Iliria" në drejtim të Matiçanit)



Objekti: rreth 1,000 m² - në gusht pritet të përfundojë ndërtimi i objektit të ri me 2,500 m² - mjedis i qetë dhe i sigurt, fusha sportive, restoranti...

Numri i fëmijëve në klasa: 20-25

Orari i punës: 8.00-16.00

Shërbimet:

- > Organizimi i procesit mësimor sipas standardeve më të larta.
- > Shërbime profesionale për fëmijë dhe për prindër.
- > Qëndrimi në shkollë prej 6-8 orë, varësisht nga mosha dhe nevojat individuale të fëmijëve.
- > Kryerja e pjesës më të madhe të obligimeve gjatë qëndrimit në shkollë.
- > Aktivitete jashtëmësimore dhe zbavitëse për fëmijë.
- > Transporti dhe ushqimi (shërbime shtesë).

Personeli: Kuadri mësimor i kualifikuar dhe i trajnuar për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit.



VIZIONI - Çfarë ne synojmë?

T'i kontribuojmë zhvillimit maksimal dhe të lirë të secilit nxënës të regjistruar në shkollë, në përputhje me aftësitë individuale psikike dhe fizike dhe me kërkesat e shoqërisë së përparuar dhe demokratike.

MISIONI Ç'obligime marrim?

Shkolla do të krijojë kushte për secilin nxënës të regjistruar të mësojë

- > Të dijë.
- > Të veprojë.
- > Të mbijetojë.
- > Të bashkëjetojë me të tjerët.
- > Të nxë gjatë tërë jetës.
- > Të transformojë veten dhe shoqërinë.



3




Edhe diçka...

Shkolla "Mileniumi i Tretë" nuk u shërben vetëm nxënësve të saj dhe prindërve të tyre, por edhe arsimit publik. Pas mbulimit të shpenzimeve të Shkollës, fitimi i realizuar shfrytëzohet për aftësimin profesional të mësimitdhënësve të shkollave publike, duke i kontribuar kështu ngritjes së cilësisë së arsimit në përgjithësi.



Mileniumi i Tretë

Skema organizative e punës edukative dhe arsimore në shkollën "Mileniumi i Tretë"...





...dhe si do të realizohet

Programi mësimor

Shkolla "Mileniumi i Tretë" punon me plane dhe me programe të avancuara të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Gjuha angleze fillon të mësohet që nga klasa e parë e shkollës fillore.

Metodat e punës

Në shkollë punohet me metodologji bashkëkohore të mësimdhënies me në qendër nxënësin:

- > Hap pas hapi.
- > Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit.
- > Zgjidhja e problemeve.
- > Të nxënit me projekte etj.

Shkolla zbaton metodologji bashkëkohore të vlerësimit, të bazuara në përcjelljen e vazhdueshme të punës së nxënësve.



Format e punës

Për të siguruar që secili nxënës të përparojë sa më shumë, në Shkollë do të zbatohen forma të ndryshme të punës:

- > Puna individuale.
- > Puna në dyshe.
- > Puna në grupe.
- > Puna frontale (me tërë klasën).

Për t'i plotësuar nevojat dhe dëshirat individuale të secilit nxënës, Shkolla do të organizojë:

- > Mësim plotësues për nxënësit që kanë vështirësi në nxënie.
- > Mësim shtues për nxënësit me prirje të veçanta.
- > Mësim zgjedhor për nxënësit që tregojnë interesim të veçantë.



Çfarë premtojmë...?

- > Krijim të mjedisit të përshtatshëm për zhvillim maksimal fizik dhe psikik të fëmijëve.
- > Krijim të fëmijët të sensit për vlerësimin e tipareve pozitive, siç janë: sinqeriteti, drejtësia, vetëbesimi, guximi qytetar, respekti ndaj të tjerëve, etj.
- > Trajtim korrekt dhe jodiskriminues të të gjithë fëmijëve dhe të prindërve.
- > Zhvillim të aftësive kreative të nxënësve dhe të aftësisë për të mësuar gjatë tërë jetës.
- > Kultivim të aftësisë drejtshkrimore në përputhje me standardet e gjuhës amtare.
- > Aftësim të fëmijëve që ta flasin dhe ta shkruajnë rrjedhshëm gjuhën angleze, të lexojnë dhe komunikojnë pa probleme në një gjuhë tjetër të huaj.
- > Shkallë maksimale të arritjes në përvetësimin e planit dhe të programit mësimor.





...dhe si do ta bëjmë këtë realitet

Hap pas Hapi

Hap pas hapi është program edukativ i hartuar nga Universiteti Georgetown në Washington dhe paraqet gërshetim të përvojave amerikane dhe evropiane për punë me fëmijët e moshës deri në 10 vjet. Ky Program realizohet në 30 vende të Botës, ndërsa në Kosovë është i pranishëm nga viti 1997.



Të gjitha paralelet e mësimit klasor (1-4) në Shkollë janë të pajisuara sipas standardeve të këtij Programi, për të mundësuar:

- > Individualizimin në mësim.
- > Të mësuarit aktiv.
- > Mundësinë që fëmijët të zgjedhin aktivitetin e dëshiruar.
- > Mjedisin stimulues për mësim.
- > Bashkëpunimin me familjen.

Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit (MKLSH)

MKLSH është program i Shoqatës Ndërkombëtare të Leximit me seli në Washington, i cili ndihmon nxënësit të mendojnë në mënyrë reflektive, të kuptojnë logjikën e argumenteve, të dëgjojnë me vëmendje, të diskutojnë haptas dhe të bëhen individë të pavarur dhe të interesuar për të nxënë gjatë tërë jetës. Ky Program zbatohet në 28 vende të Botës, ndërsa në Kosovë ka filluar të zbatohet që nga viti 2000.

MKLSH është program i përshtatshëm për punë me nxënës të të gjitha moshave dhe nxit një bashkëpunim të mirë mes nxënësve, si dhe mes nxënësve e mësimitdhënësve.





Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Themeluesi i Shkollës

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është organizatë joqeveritare dhe jopërfituese e themeluar nga Fondacioni "Soros" në vitin 2000. KEC përqendrohet kryesisht në trajnimin e punëtorëve të arsimit për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të udhëheqjes, por zhvillon edhe një varg aktivitete të tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit në Kosovë. Të arriturat kryesore të KEC në periudhën 2000-2006 janë:

- Themelimi i rrjetit të 6 qendrave të trajnimit në Prishtinë, në Prizren, në Ferizaj, në Pejë, në Gjakovë dhe në Gjiçan.
- Trajnimi i mbi 10,000 mësimdhënësve dhe administratorëve të të gjitha niveleve të arsimit.
- Zhvillimi i programeve specifike të trajnimit për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe përshtatja e programeve të njohura ndërkombëtarisht në këto fusha, p.sh. Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit dhe Hap pas hapi.
- Programet e trajnimit për udhëheqje efektive në arsim, në planifikim, të drejtat e fëmijës etj.
- Publikimi i mbi 20 titujve nga fusha e arsimit dhe i një numri të madh studimesh.

KEC ka 26 të punësuar në marrëdhënie të përhershme pune dhe rreth 40 bashkëpunëtorë të jashtëm nga Kosova dhe Shqipëria. Partnerët kryesorë të KEC janë MASHT, Fondacioni "Soros", Banka Botërore, Projekti Kanadez për Zhvillimin e Mësimdhënësve (KEDP), dhe një numër i konsiderueshëm organizatash të tjera qeveritare dhe joqeveritare.

Informatat dhe regjistrimet:

Shkolla "Mileniumi i Tretë"
rr. Isa Kastrati p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel. **038/244 258**
E-mail: info@mileniumi3.net
<http://www.mileniumi3.net>

Çdo ditë pune prej orës 8.00-16.00